

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektsh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Inxhinier Projektues

❖ DETYRAT KRYESORE

- Përgjegjës për organizimin e punës për detyrën e projektimit për projektet e realizuara nga të tretë;
- Aftësi organizative, menaxhimi dhe planifikimi, përfshi aftësinë për të kryer disa punë njëherazi;
- Bashkëpunim i ngushtë me ekipin e profesionistëve të tjerë, si inxhinierë, menaxherë të fushës së ndërtimit;
- Kryen rol teknik, organizativ dhe supervisor për projektet në ndërtim;
- Harton gjithë dokumentacionin e nevojshëm të objekteve të planifikuara për tu ndërtuar nga kompania;
- Kontrollon, vlerëson & rishikon projektet nga ana teknike;
- Përgjegjës për dhënien e zgjidhjeve teknike në lidhje me punimet inxhinierike si dhe hartimin e raporteve teknike Përgjegjës për përgatitjen e plan organizimit të punimeve;
- Përgjegjës për përgatitjen e metodikave të ndryshme të punimeve për punimet civile për fazën e tenderit dhe zbatimit;
- Përgjegjës për raportimin javor për shërbimet e kryera tek eprori;
- Përgjegjës për analizimin e problematikave nga kantieri dhe dhënien e zgjidhjes/ve teknike optimale;
- Kryen vlerësimin e zgjidhjeve teknike nga palë të treta dhe propozon përmirësime;
- Rishikimin e specifikimeve teknike, përgatitjen e tyre nëse është e nevojshme;
- Merr pjesë në vlerësimin teknik të ofertave në procedura prokurimi ose tendera;
- Projektimin e projekteve të vogla duke përfshirë gjithë elementet si: Vizatimet e detajuara, raportet etj.

❖ KRITERET KRYESORE

- Inxhinieri Ndërtimi. Strukturist ose Infrastruktura
- Mbi 7 vite eksperience në Projektim dhe Zbatim godinash dhe infrastrukture;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi në Shqipëri dhe Anglisht (gjuhët shtesë janë plus);
- Aftësi për të punuar dhe organizuar punën në grup (shumë e rëndësishme);
- Aftësi për të punuar pa supervizim;
- Aftësi raportuese

Te gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dergojnë CV nepermjet adresës së e-mailit careers@gener2.al ose të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare www.gener2.al në seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 25 Korrik 2022**, ora 17:00.

* Vetëm kandidatet e perzgjedhur do të kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”.